



Raport vjetor 2021

QENDRA RINORE ARDHMËRIA – KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2021

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2021

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmëria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2021.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmëria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

2. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET

3. PROJEKTET

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

1.1 PUNTORI EDUKATIVE PËR FËMIJË ME RASTIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS.

Me 17 Shkurt 2021 festuam 13 vjetorin e pavarësisë, të rinjtë dhe fëmijët organizuan një punëtori edukative dhe kulturore për të festuar ditën e Pavarësisë së Kosovës. Në këtë aktivitet morën pjesë 20 fëmijë, dhe grupi I të rinjve që në mënyrë edukative dhe kreative punuan flamurin e Kosovës si dhe u argetuan me këngë dhe valle.



1.2. DITA E GRUAS - 8 MARS 🌸

Më 8 mars të vitit 1910 në SHBA , Kanada e në vende të tjera të botës u bënë protesta të mëdha për të drejtat e gruas dhe pikërisht atë ditë të drejtat e gruas dhe të burrit janë të drejta.

Tradicionalisht për çdo 8 mars fëmijët në shumë vende të botës ju dhurojnë nënave të tyre lule e gjëra të tjera në shenjë dashurie për nënën.

Vullnetarët e Qendres Rinore kanë punuar lule kreative, të cilat janë shpërndarë për gratë e qytetit të Klinës. Shpërndarja e lulëve kishte për qëllim të gëzojm dhe respektojm të drejtat e grave.



1.3. 22 MARS –DITA BOTËRORE E UJIT.

Grupi i vullnetarëve të organizatës kanë organizuar event edukativ për ditën botërore të ujit, kjo ngjarje ka për qëllim edukimin dhe vetëdijësimin e të rinjve për ujin, dhe rëndësinë e mbrojtjes së ujërave në komunën e Klinës.


Eventi ka përfshirë ligjerata për ujin dhe lojra edukative për fëmijë.

Në këtë aktivitet morën pjesë të rinjtë e moshës 10-12 vjeç të qytetit të Klinës.



1.4 ANGAZHIMI I TE RINJEVE

Programi virtual arriti të zhvilloj plane dhe propozime për qendren rinore si dhe zhvilloi workshope virtual me të rinjtë e qytetit të Klinës të cilët përfituan njohuri dhe zhvilluan aftësitë e buta në Komunikim. Në këtë workshop moren pjesë disa të rinjë aktiv të organizates.



1.5 DITA BOTËRORE E SHËRBIMIT RINOR NË KOMUNITET.

Të rinjtë nga Klina mbollën 100 lule në parkun e Klinës. Aktiviteti kishte për qëllim edukimin e të rinjve për mjedisin natyror dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e mjedisit. Grupi i të rinjve u kënaq duke mbjellë lule me të rinjtë dhe fëmijët e vegjël që i'u bashkuan aktivitetit. Aktiviteti u mbështet nga vullnetarët dhe fëmijët



1.6 DITA EVROPE

Me 9 Maj, në ditën ndërkombëtare të Evropës, është organizuar një fushatë lobuese ku të rinjtë ngriten zërin e tyre nëpërmjet videos digjitale duke dhënë një mesazh për liberlizimin e vizave. Të rinjtë e Kosovës kanë të drejtë të jetojnë të lirë ashtu siq e kanë të gjithë të rinjtë e Evropës.

Happy Europe Day to all Europeans, Kosovo youth need visas and we want European support.



1.7 SESSION INFORMUES

Me 26 Maj, në Qender Rinore, u mbajt një sesion informues mbi mundësinë e aplikimit për trajnimin "Lajmëtarët e Ballkanit" i cili do të mbahet nga 15 deri më 21 qershor në Kratovo, dhe në të cilin do të marrin pjesë 15 të rinj nga Maqedonia e veriut, Kosova dhe Serbia.

Sessioni informuas është zhvilluar me qëllim të motivimit të të rinjëve për pjesëmarrje në programet ndërkombëtare.



1.8 DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE - 1 QERSHORI

Grupi i vullnetarëve të organizatës kanë organizuar lojra edukative për ditën ndërkombëtare të fëmijëve kjo ditë festive për fëmijë ka për qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirqenies së tyre. Kjo ditë lumturoi fëmijët të cilët paten mundësi të luajn dhe të argetohen gjatë të gjitha lojrave në Qender Rinore.


Ishtë kënaqësi të shihje fytyrat e secilit fëmijë të qeshur dhe të gëzuar në këtë festë edukative. Urime festa 1 Qershorit.



1.9 SESSION ORIENTUES

Sesion orientues për pesë (5) pjesëmarrsit nga Kosova që do të marrin pjesë në Kursin i trajnimit " Lajmëtarët e Ballkanit - Roli i Mediave në Krijimin e Rrëfimeve Alternative". Përfitues të trajnimit në Kratovo do të jenë të rinjë nga Prishtina, Peja, Mitrovica, Prizreni dhe Podujeva.

Sessioni orientues është organizuar më qëllim që të informojm dhe përgadisim grupin nga Kosova për pjesëmarrje dinjitoze në Trajnimin që organizohet nga Shoqata për Zhvillim Arsimor EKVALLIS dhe partnerët e saj mbështeten nga RYCO brenda thirrjes së 4-të të hapur për projekt propozime të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.



1.10 PROGRAMI VEROR 2021

Programi veror është zhvilluar nga 12-23 Korriku dhe ka zgjatur dy javë me aktivitete për fëmijë. Programi ka pasur për qëllim zhvillimin e të rinjve për të udhëhequr dhe zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet e të rinjve për të punuar me fëmijë.

Programi është zhvilluar çdo ditë dhe në secilin ditë kanë qenë të angazhuar shumë vullnetarë për të realizuar aktivitetet me fëmijë. Aktivitetet kanë filluar me lojëra dhe aktivitete edukuese për moshën 6-10 vjeq. Gjithashtu në kuadër të programit janë zhvilluar Animacione, ërkshope dhe lojëra në natyrë.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve është përdorur metoda edukimit jo-formal dhe puna ekipore kreative për të edukuar fëmijët si dhe të njëjten kohë të zhvillojnë lojëra dhe të arretohen njëkohësisht.

Programi veror është përmblytur me aktivitetin “Gjetja e thesarit” në mënyrë që fëmijët të mësojnë historinë e qytetit të Klinës dhe të mësojnë rreth monumenteve historike të qytetit. Për të përfunduar të gjithë programin, kemi reflektuar në të gjitha aktivitetet e zhvilluara, gjithashtu është zbuluar shoku sekret i cili gjatë gjithë programit secili pjesëmarrës u mbështet nga shoku sekret, me dhurata dhe mesazhe, për të ndjekur procesin e të mësuarit dhe shoqërimin e secilit pjesëmarrës.

Vullnetarët organizuan një koktej për fëmijët dhe gjithashtu lojëra dhe vallëzim për grupin. Të gjithë të rinjtë kanë kaluar një kohë të mrekullueshme gjatë programit veror.



1.11 TRAJNIM-GRUPET RINORE NË VEPRIM-JASHANICË

Trajnimi 3 ditor është organizuar në SHFMU “Tre Dëshmoret” në Jashanicë, Trajnimi ka pasur për qëllim krijimin e grupit rinor në zonat rurale gjegjësisht të krijohet një grup rinor i cili përbehet nga të rinjtë e asaj zone. 20 të rinjtë të moshës 14-15 vjeqë kishin mundësi që të zhvillojnë kapacitetet e tyre në identifikimin e nevojave të komunitetit dhe punës ekipore në menaxhimin e rrjeteve sociale dhe promovimin e grupit rinor.

Qendra Rinore arriti që të krijoj nje grup rinor 'Bashkimi Rinor-Jashanicë" i cili do të jëtë pikë referimi dhe komunikimi me të rinjtë tjerë. Trajnimi " Grupet rinore në Veprim" është zhvilluar në fshatin Jashanice, prej 8-10 Tetor 2021



1.12 TRAJNIM-GRUPET RINORE NË VEPRIM - SFERKE

Me 13- 15 Tetor 2021 është organizuar trajnimi 3 ditor për grupet rinore në zonat rurale, të rinjtë kishin mundësi që të zhvillojn kapacitet e tyre në punën ekipre dhe menaxhimin e rrjeteve sociale si dhe inicimin e aktiviteve rinore ne komunitet.

Qendra Rinore zhvilloi trajnimin 3 ditor me 20 të rinjë të moshes 14-15 vjeq nga SHFMU "Emin Duraku-Sferkë" . Përfituesit dhe arsimtarët janë treguar shume mirëprites dhe bashkëpunuesnë realizimin e trajnimit për rini, gjithashtu ne ditën e fundit të trajnimit është krijuar grupi rinor [#Rinia Në Veprim](#) të cilit i urojm punë të sukseshme në realizimin e aktiviteve të mëtutjeshme në të ardhmen.

INCIATIVA-Si rezultat I trajnimit me 27 Tetor 2021 Grupi rinor [#Rinia Në Veprim](#) ka organizuar **Iniciativen e parë me realizimin e nje fushate** me qëllimit të ngritjes së vetëdijes mbi përhapjen dhe ndikimin negativ të bullizmit në shkolla.

Për t'i thënë STOP këtij problemi dhe për të treguar që grupi rinor nuk e mbështet këtë fenomen, kanë pregatitur një video të shkurtër digjitale ne rrjetet sociale face book.

Video digjitale është përkrahur nga drejtori i shkollës z. Fahredin Gashi dhe arsimtarët Luan Berisha dhe Sali Berisha për mbështetjen e dhënë gjatë realizimit të këtij projekti !



1.13 TRAJNIM-GRUPET RINORE NË VEPRIM-GLLAREVË,

ME 20-22 Tetor 2021 është organizuar trajnimi ne SHFMU "Dëshmoret e Qëndresës-Gllarevë për grupet rinore në zonat rurale, të rinjtë kishin mundësi që të zhvillojn kapacitet e tyre në punën ekipre dhe menaxhimin e rrjeteve sociale si dhe inicimin e aktiviteve rinore ne komunitet.

Qendra Rinore arriti të krijoj grupin rinor [Rinia Aktive e Gllarevës](#) në mëyrë që të kemi më të lehtë komunikimin në mes të rinjve të qytetit dhe zonave rurale.

INCIATIIVA-Në kuadër të fushatës Grupi Rinia Aktive e Gllarevës, me nxënësit e shkollës shfmu " Dëshmorët e Qëndresës" në Gllarevë, ka zgjedhur të shënojë 20 Nëntorin - Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, në veçanti Konventën për të Drejtat e Fëmijëve që fuqishëm deklaroi vullnetin për respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e mirëqënies së tyre. Grupi: Rinia Aktive e Gllarevës gjatë fushatës përmes aktiviteteve kreative me nxënësit kemi dashur të ngrisim vetëdijen për rëndësinë e mësimnxënies kreative si formë e duhur për të stimuluar mendimin kritik dhe idetë origjinale të nxënësve, si dhe të adresojmë nevojën për arsimim cilësor për të gjithë nxënësit në shkollën tonë dhe gjithë Kosovën. Arsim cilësor për të gjithë fëmijët! (video digjitale) (1) [Rinia Aktive e Gllarevës | Facebook](#)



1.14 **TRAJNIM-GRUPET RINORE NË VEPRIM-DRENOC**

Me 3-5 Nentor, Trajnimi 3 ditor është organizuar në kuadër të projektit "Grupet rinore në Veprim" i cili përqendrohet në fushën e Zhvillimit të Rinisë dhe angazhimit të tyre si qytetarë aktiv në shoqëri. Në këtë trajnim morën pjesë nxënësit nga SHFMU "Isa Boletini-Drenoc. Si rezultat i këtyre trajnimeve është krijuar grupi rinor i thirrur si [#Rinianendryshim](#)

INCIATIIVA- [#Rinianendryshim](#) filloi iniciativën e tyre të parë dhe organizuan një fushatë vetëdijësuese për Parandalimin e lëndëve narkotike. Në ditët e sotme lëndët narkotike në shkollë janë bërë një shqetësim shumë serioz. Dhe të rinjtë e fshatit Drenoc e shohin si Problemi alarmant përdorimin e lëndëve narkotike në shkollë dhe hapsira publike. Grupi rinor ka inxhizuar një video të shkurtër dhe e ka publikuar në rrjetet sociale në mënyrë që së bashku me bashkëmoshatar mund ta parandalojnë një dukuri negative në shoqëri. [#Rinianendryshim](#) (Punuar me 19 Nëntor 2021)



1.15 **HALLOWEEN N'KLINË**

Origjina e Halloween-it mund të gjurmohet që nga koha antike. Shumica tregojnë Samhain, një festival kelt që përkujton fundin e sezonit të korrjes dhe turbullimin e botës fizike dhe shpirtërore, si paraardhësi i Halloween-it. Me kalimin e shekujve, festa evoluoi, duke marrë ndikime të ndryshme. Sot, Halloween festohet me kostume, ngjyrosje fytrash, fenerë dhe filma të frikshëm – të gjitha gjërat që janë të panjohura për ata që marrin pjesë në festën Halloween.

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë këtë vit ka angazhuar të rinjë për të zhvilluar lojëra argetuese për nxënësit parafillor të qytetit të Klinës. Vullnetaret kanë zhvilluar lojëra me shpërblime "Trick or Treat" me nxënësit e 3 klasave parafillor të shkollës "Ismet Raci" dhe nxënësit e klasës parafillor të shkollës "Motrat Qiriaz" në Klinë.

Organizimi i lojërave për fëmijë është mundësuar me përkrahjen e Mesuesve të klasave parafillor, dhe përkushtimin e punës vullnetare.



1.16 RIFRESKIMI I GRUPIT RINOR-KLINA YOUTH CHAPTER

Si traditë e rifreskimit të të dhenave, dhe mundësin e antarësimit në grupin rinor, Qendra rinore ju mundëson rizgjedhjen e kryesis së grupit si dhe antarësimin e anatarëve të rinjë në kuvend. Klina youth chapter me 11 Nëntor 2021 ka një kryesi të re lidershipi dhe përfqasim në rrjetin ndërkombëtare People to People International. (11 Nentor 2021)




1.17 DITA NDËRKOMBËTARE E HIV/AIDS.

Me 1 Dhjetor, Dita ndërkombëtare e HIV/AIDS, Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë ka angazhuar vullnetar që të mbajnë ligjeratë vetëdijësuese dhe informuese për të rinjtë e moshës 13-15 vjeç të shkollave fillore në qytetin e Klinës, po ashtu edhe pjesëmarrës nga një grupinor nga SHFMU "Isa Boletini" Drenoc.

Ligjerata i'u shërbej të rinjve që të kenë kujdes nga sëmundjet ngjitëse siq është HIV/AIDS. Gjithashtu gjatë ligjerimit është përdorur metoda e dukimit jo- formal me energizer dhe prezantime në power point të përgaditur nga vet vullnetaret: Elsa Gashi, [Dea Bekaj](#) dhe [Arita Sverka](#).

Ne kuader te ditës ndërkombëtare kunder Hiv/Aids është organizuar edhe një fushatë digjitale, ku të rinjtë e qytetit të Klinës llobojn për parandalimin e sëmundjes seksualisht transmetuse. [Fushata "Sëbashku mund ta parandalojm Hiv/Aids" Campagn "Together we can prevent HIV / AIDS. - YouTube.](#)

Falenderojm të gjithë vullnetaret e [Qendra Rinore Ardhmëria Klinë](#) për organizim dhe përkrahje, gjithashtu falenderojm edhe grupet rinore #Riniane Ndryshim dhe #Rinia ne Veprim për pjesëmarrje në fushatat digitale.



1.18 AKTIVITETET HUMANITARE

Nata e filmit: Në qender janë organizuar 3 netë për shfaqje të filmit, në mbrëmje tri netë janë shfaqur Filma për të Rinjë ndersa dy dite janë shfaqur filma për fëmijë në Kohën e paradites.

Punimi i kartolinave: Kemi organizuar workshope të përditshme ku të rinjtë sipas kohës së tyre të lirë kanë punuar kartolina creative si dhe janë shirt nga vet vullnetaret në qender të qytetit me qëllim për të ngritur fondin për familjet në nevojë.

Shitja e embëlsirave: Të rinjtë organizuan që secili prej tyre të gatujn embëlsira dhe torte në shtëpi dhe ato të sjellin në grup që së bashku dy ditë të ftoftë dimri të shesin në qytet.

Bizneset Private: Dy grupe të të vullnetareve kanë vizituar bizneset e qytetit të Klinës në mënyrë që të mbledhim fonde për bamirësi, dhe mund të shprehemi se më shumë përkrahje kemi pasur nga bizneset e vogëla sesa nga ato biznese të mëdha.

Grupi I të rinjve me shumë vullnet dhe sacrifice arrihen të krijojnë një fond për të ndihmuar disa familje në nevojë.

(punuar prej 5 -20 Dhjetor 2021)



1.19 NDIHMAT HUMANITARE

E Merkurë, 22 Dhjetor 2021 janë përndarë pako ushqimore për 10 familje me asistencë sociale, Shpërndarja e pakove ushqimore është bërë nga antarët e qendres Qendra Rinore Ardhmëria Klinë. Grupi i të rinjve është angazhuar dhe kanë punuar me një vullnet dhe përkushtim që nga fillimi i muajit Dhjetor për të mbledhur një fond solidar për bamirësi. Rinia dhe qytetarët e Klinës janë gjithmonë solidar dhe të gatshëm për të ndihmuar disa familje në Komunën e Klinës për festën e Krishtlindjes dhe Vitit të ri 2022.

Presim, që edhe autoritet lokale të marrin përgjegjësin dhe përkushtimin e tyre me seriozitet me të lartë në sektorin social dhe menaxhimin e asistencës sociale në mënyrë të duhur dhe korrekte.

Falenderojmë të gjithë qytetarët e Klinës, Familjarët e vullnetarëve dhe Bizneset private për kontributin e dhënë në aktivitetin humanitar që është inicuar dhe zhvilluar nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë. (22 Dhejtor 2021)



1.20 CHRISTAMS PARTY

Me eventin tonë final 🎉 Christmas party 🎉 përfunduar vitin 2021.

Vullnetarët kaluan një mbrëmje festive dhe shumë argëtuese, ku gjithashtu kanë reflektuar të gjitha aktivitetet e organizuara gjatë tërë vitit 2021.

Vullnetarët janë Certifikuar për punën vullnetare gjatë tërë vitit 2021, gjithashtu ekipi i organizatës është shumë mirënjohës për të gjithë ata që kontribuan në zhvillim dhe aktiviteteve rinore në Klinë.

- Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e ri 2022 🎄🎁🎉🎊





2. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

2.1 PARTNERSHIP- EKVVALIS

Projekti “Lajmëtarët e Ballkanit – Roli i medias në krijimin e narrativave alternative” është implementuar nga Shoqata për Zhvillimin e Arsimit EKVVALIS dhe partnerët e saj, Qendra Rinore Ardhmeria Klinë dhe BalkanIDEA Novi Sad, janë mbështetur nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor - RYCO në kuadër të Thirrjes së 4-të të Hapur për Propozime Projektesh të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Ky projekt është zhvilluar prej 26 Shkurt- 26 Shtator 2021, dhe kishte për qëllim të zhvillonte trajnim edukativ, përfituan aktivistë të rinjë nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia të cilët kanë pasur përvojë të madhe në aktivizmin për komunitetet e marginalizuara, regjimet shtypëse dhe që kanë prapavijë si mbrojtës të demokracisë.

QRAK në kuadër të projektit ka organizuar sesione informuese për të rinjë, ka selektuar 5 pjesëmarrës nga Kosova, ka organizuar session orinetues për grupin. Grupi rinor ka marr pjesë në Trajnimin 7-ditor në Kratovo të Maqedonise se veriut. Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit nga Kosova kanë zhvilluar intervista dhe janë përgaditur 3 rrëfime alterantive të cilat janë publikur në rrjetin social Podcast në linkun:

<https://anchor.fm/.../Life-of-Serbian-Minorities-in...>

<https://anchor.fm/.../Sexism--Virginity-and-being-a-ëoman...>

Zhvilluar prej 26 Shkurt-26 Shtator 2021

2.2 PARTNERSHIP –INITIATIVE CHRISTEN FÜR EUROPA-GERMANY-ESC.

Organizata partnere nga Gjermania ka përzgjedhur një vullnetare nga Istogu (Flutura Alihajdaraj) për të punuar si vullnetare e solidaritetit evropian në Campus Regensburg në periudhë 12 mujore. Qendra Rinore Ardhmeria është organizata derguese dhe projekti ka filluar në Shtator 2021 dhe do të përfundoj në fund të Shtatorit 2022. Projekti është financuar nga Erasmus+ me qëllim që të zhvillohen aftësitë rinore dhe për të shkëmbyer kultura të ndryshme.

Shtator 2022

2.3 PARTNERSHIP-HUMAN

Në projektin “Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet OSHC-ve dhe Institucioneve publike në promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë” QRAK është partnere lokale dhe ka përgjegjësi për mobilizimin e vullnetarëve dhe vizitën e familjeve derë më derë, bisedën me familjarët dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve, duke rritur në këtë mënyrë ndërgjegjësimin e qytetarëve në zonat rurale për antikorrupsionin, sundimin e ligjit, etikën në qeveri dhe publik. arsimimi.

Zhvilluar Janar- Gusht 2021

2.4 VIRTUAL PILOT PROJEKT-KORPUSI I PAQES

Korpusi i Paqes ftoi Qendrën Rinore Ardhmeria të bashkohet me një Program Pilot të Shërbimit Virtual. Në këtë program unik, dy vullnetarë të kthyer të Korpusit të Paqes me banim në Shtetet e Bashkuara u angazhuan me Qendrën Rinore në një format virtual. Nëpërmjet këtij projekti dhe nën drejtimin e znj. Zefi, Qendra Rinore Ardhmeria zgjeroi kapacitetet e saj për të angazhuar në mënyrë virtuale palët e interesuara. Ky projekt bashkëpunimi dhe ndërtimi i kapaciteteve shkoi aq mirë, sa u zgjat nga afati kohor fillestar prej dymbëdhjetë javësh në njëzet e katër javë.

Qendra Rinore Ardhmeria, znj. Zefi dhe stafi tjetër kanë qenë present dhe treguan ndikim të qëndrueshëm tek të rinjtë në komunitet dhe kanë demonstruar sinqeritetin, besueshmërinë, përkushtimin dhe përkushtimin e tyre si partner dhe agjenci mikpritëse e Korpusit të Paqes në Kosovë.rinjë.

Shkurt-Qershor 2021



3. PROJEKTET

3.1 FUQIZIMI I RINISË NË KLINË

Projekti "Fuqizimi i Rinisë në Klinikë", janë organizuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë me përkrahjen e Subvencionit të Komunës së Klinës dhe gjëgjësisht Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve: Ligjerata për vetëdijësim dhe parandalimin e sëmundjeve infektuese, Ligjerata për vetëdijësimin e higjenes personale, Ëorkshop për zhvillim të aftësive të buta Fushatë motivuese për iniciativat rinore në komunitet.

Implementuar Korrik-Dhjetor 2021.

3.2 GRUPET RINORE NË VEPRIM

Projekti "Grupet Rinore në Veprim" projekt I financuar nga MKRS. Projekti ka arritur qëllimin dhe ka krijuar grupet rinore në zonat rurale, si dhe janë zhvilluar iniciativa për aktivizmin rinor në komunitet. Kemi arritur që të zhvillojm trajnime me të rinjë dhe të cilët kanë përvetsuar aftësitë për të funksionuar si grup rinor në zonen e caktuar. Grupet rinore janë inkurajuar që të marrin pjesë në këshillat rinor dhe iniciativat e ndryshme që organizohen për rini. Deri me tani kemi arritur që të kemi një komunikim të mirë me 4 grupe rinore dhe disa prej antarëve janë angazhuar edhe në aktivitete dhe iniciativa tjera të qendres rinore. Secili grup rinor ka hapur një faqe sociale në facebook dhe secili prej tyre kanë zhvilluar Fushata vetëdijësuese me tema të caktuar nga vet të rinjtë.

Implementuar Gusht-Dhjetor 2021

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

